



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 37

Tiranë – E hënë, 30 shtator 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 399, datë 23.9.2019	Për hapjen e procesit, për shprehjen e interesit, për t'u për zgjedhur si kandidat që do t'i propozohet Kuvendit të Shqipërisë për t'u zgjedhur në pozicionin e anëtarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1188, datë 26.9.2019	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Bashkisë Elbasan..... 4
Njoftim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. 255, datë 26.9.2019	Për shpallje konkurrimi për vend të lirë pune, sipas procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për pozicionin e Kryesekretarit në këtë institucion..... 5
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 5756, datë 6.9.2019	Për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë "G&T" sh.p.k..... 7

**VENDIM**

Nr. 399, datë 23.9.2019

**PËR HAPJEN E PROCESIT, PËR
SHPREHJEN E INTERESIT, PËR T'U
PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT QË DO
T'I PROPOZOHEK KUVENDIT TË
SHQIPËRISË PËR T'U ZGJEDHUR NË
POZICIONIN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË
KONKURRENCËS**

Presidenti i Republikës, pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 3092/1 prot., datë 13.9.2019, se mandati 5-vjeçar i zotit Eduard Ypi, si anëtar i Komisionit të Konkurrencës, përfundon në datën 30.10.2019, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe me vullnetin për realizimin e një procesi objektiv e transparent për të siguruar përzgjedhjen e një kandidature me integritet të lartë moral dhe profesional të përshtatshme për këtë pozicion,

VENDOSI:

1. Hapjen e procesit për çdo të interesuar që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Presidentit të Republikës.

2. Shpallja e këtij procesi dhe publikimi sipas tekstit bashkëlidhur, të bëhet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe në mjetet e informimit publik.

3. Afati i publikimit në faqen zyrtare të institucionit dhe i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, do të jetë nga data 23 shtator 2019 deri në datën 3 tetor 2019, ora 14:00.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të nxjerrë aktet e nevojshme për procedurën e administrimit të dokumentacionit për këtë proces.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

NJOFTIM

Nr. 3325/1, datë 24.9.2019

**PËR HAPJEN E PROCESIT, PËR
SHPREHJEN E INTERESIT,
PËR T'U PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT
QË DO T'I PROPOZOHEK KUVENDIT
TË SHQIPËRISË PËR T'U ZGJEDHUR
NË POZICIONIN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NË
AUTORITETIN E KONKURRENCËS**

Presidenti i Republikës, pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 3092/1 prot., datë 13.9.2019, se mandati 5-vjeçar i zotit Eduard Ypi, si anëtar i Komisionit të Konkurrencës, përfundon në datën 30.10.2019, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe me vullnetin për realizimin e një procesi objektiv e transparent për të siguruar përzgjedhjen e një kandidature me integritet të lartë moral dhe profesional të përshtatshme për këtë pozicion, ka vendosur:

Hapjen e procesit për çdo të interesuar, që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Presidentit të Republikës.

Në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9121/2003, anëtarët e Komisionit të Konkurrencës zgjidhen nga Kuvendi, me kandidatura të ndryshme, ku një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës. Anëtar i Komisionit të Konkurrencës mund të zgjidhet kandidati që plotëson kushtet e parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, që të marrë pjesë në këtë proces publik e të shprehë interesin për të qenë kandidat për Anëtar të Komisionit të Konkurrencës, të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesën për shprehjen e interesit;



- Jetëshkrimin në gjuhën shqipe me të dhënat e plota të kontaktit;

- Kopje të noterizuar të dokumentacionit shoqërues që vërteton përmbushjen e kushteve dhe kriterëve për t'u zgjedhur në këtë pozicion, të përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si:

- Të jetë shtetas shqiptar;

- Të ketë vjetërsi pune në profesion jo më pak se 15 vjet;

- Të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti "E drejtë civile /administrative";

- Të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejtpërsëdrejti në mjediset e selisë së Presidentit, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, do të jetë deri në datën 3 tetor 2019, ora 14:00.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e personave, të cilët kanë shprehur interesin do të bëhet publike në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Kandidatit/ëve të përzgjedhur do t'u kërkohet paraqitja e dokumentacionit shtesë si më poshtë:

- Formulari i vetëdeklarimit, i plotësuar dhe i nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Formulari i aplikimit, i plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

- Vetëdeklarimi i aplikantit se nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të papajtueshmërisë së funksionit sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

Propozimi, që Presidenti i Republikës do t'i përcjellë Kuvendit të Shqipërisë, do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

NJOFTIM

Nr. 1188, datë 26.9.2019

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Elbasan

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	"Bodrum" nën pallatin nr. 57	Elbasan	1 014 420	889 103	125 317	55	55 m ² (sip. takuese 9.17 m ²)	23.10.2019	09:00	DDPP



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë Komisionit të Ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë Komisionit të Ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfutur kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të

Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

NJOFTIM

Nr. 255, datë 26.9.2019

PËR SHPALLJE KONKURRIMI PËR VEND TË LIRË PUNE, SIPAS PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE DHE NGRITJES NË DETYRË

Në zbatim të ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe të Kodit të Punës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpall konkurrimin për një vend të lirë pune, **nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë** (të dyja procedurat zhvillohen në të njëjtën kohë), në pozicionin:

Kryesekretar

Kategoria e pagës III-b

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për kategorinë që konkurrohet. Për të dyja procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë.

**Neni 431 i ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016****Kryesekretari**

- Kryesekretari ka në kompetencë bashkërendimin, organizimin dhe ndarjen e punës së zyrës së sekretarisë nën drejtimin e kancelarit të gjykatës.

- Kryesekretari ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) Lëshon vërtetime për të dhënat e kërkuara nga palët nga regjistrat në gjykatë;

b) Nënshkruan të gjitha aktet procedurale që kërkojnë njoftime procedurale, siç janë:

i. vendimet gjyqësore që bëhen përfundimtare;

ii. vendime përfundimtare dhe të ndërmjetme që dërgohen për ekzekutim;

iii. ekstrakte dhe fotokopje të njësuar me origjinalin të akteve të gjykatës;

iv. të gjitha aktet e tjera të nxjerra nga gjykata, krahas nënshkrimit të personit që i ka përgatitur;

c) Çdo detyrë tjetër e përcaktuar me ligj.

Përshkrimi i punës:

1. Organizon rregullisht punën e vet, si edhe organizon dhe mbikëqyr punën e sekretarisë gjyqësore dhe i raporton periodikisht Kancelarit dhe Kryetarit mbi mbarëvajtjen e punëve në fjalë;

2. Ushtron detyra procedurale, në përputhje me legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi;

3. Në bashkëpunim me zyrën e statistikave, bashkërendon punën në lidhje me statistikën gjyqësore dhe siguron çdo informacion të kërkuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë, në lidhje me rastet specifike;

4. Sigurohet që palëve t'u dërgohen njoftimet lidhur me vendimet e marra nga gjykata;

5. Bashkërendon me gjyqtarin respektiv të çështjes që afatet procedurale për paraqitjen e dosjeve në sekretarinë gjyqësore të përmbushen dhe informon Kancelarin dhe Kryetarin në mënyrë periodike lidhur me ecurinë e dorëzimit të dosjeve.

6. Trajton problematikat e mundshme në lidhje me procesin e dorëzimit të dosjeve;

7. Ofron informacion për palët e interesuara në lidhje me ecurinë e seancave gjyqësore;

8. Trajton kërkesat e parashtruara nga palët për shtyrjen e seancave etj. dhe i kalon këto kërkesa të gjyqtari që ka çështjen në ngarkim;

9. Merr pjesë në hapjen, mbajtjen dhe mirëmbajtjen e regjistrave, të cilët duhet të depozitohen me shkrime të thjeshta, të qarta dhe të lexueshme dhe me bojë të së njëjtës ngjyrë;

10. Numëron regjistrat me shënim në faqen e fundit, të nënshkruar nga kancelari dhe të vulosur me vulën e gjykatës;

11. Regjistron në regjistrat fizikë dhe në sistemin kompjuterik të gjykatave vendime të gjykatave të apelit dhe Gjykatës së Lartë;

12. Lëshon vërtetime nga regjistrat e gjykatave, për të dhënat e kërkuara nga palët;

13. Kur një çështje apelohe, dërgon letrat e çështjeve në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë;

14. Bashkërendon procesin e njoftimit të ankimeve dhe dërgimin e dosjeve në Gjykatën e Apelit, si dhe informon Kancelarin dhe Kryetarin në rast të pengesave apo të problematikave të mundshme;

15. Ndjek procesin e përcjelljes së buletineve të vendimeve penale;

16. Regjistron në regjistra dhe në sistem çështjet e ardhura për gjykim.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Të jetë diplomuar në drejtësi të paktën në nivel master profesional ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë.

2. Të kenë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune si sekretar gjyqësor.

3. Të ketë aftësi të mira komunikuese

4. Të ketë njohuritë bazë në përdorimin e kompjuterit.

5. Eksperienca në punë përbën avantazh.

6. Nota mesatare përbën avantazh.

7. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqesë kandidati për procedurën e lëvizjes paralele:

Kandidati duhet të paraqesë pranë institucionit këto dokumente:

1. Kërkesa e kandidatit drejtuar institucionit;

2. Jetëshkrimi i kandidatit (CV);

3. Diploma universitare me listën e notave (kopje e noterizuar);



4. Fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë personale me fotografi;

5. Libreza e punës;

6. Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata se nuk është në procedim hetimor dhe gjyqësor;

7. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;

8. Vërtetim vendbanimi;

9. Certifikatë/diplomë për njohuritë e kompjuterit (kopje e noterizuar);

10. Dëshmi të tjera kualifikimi, nëse ka;

11. Raport mjekësor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në origjinal ose të noterizuara.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht për skualifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri në datën 25.10.2019.

Intervista, për kandidatët që do të kualifikohen, do të zhvillohet në datën 1.11.2019, ora 09:00.

**KRYETAR I GJYKATËS
Esmeralda Xhili Çeka**

**VENDIM
Nr. 5756, datë 6.9.2019**

PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT TË SHOQËRISË “G&T” SHPK

Në emër të Republikës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ë përbërë nga:

Gjyqtare: Marinela Osmani

asistuar nga **sekretare gjyqësore Rovenah Behaj**, sot në datën 6.9.2019, përfundoi shqyrtimin në dhomë këshillimi, çështjen tregtare nr. 313, që i përket:

KËRKUESE: Shpresa Breçani, Administratore e Falimentimit të Shoqërisë “G&T” sh.p.k., në falimentim.

OBJEKTI: Mbyllja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijuese të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit të si më lart, pasi realizoi mbledhjen përfundimtare të kreditorëve të falimentimit dhe dëgjoi ata dhe

Administratoren e Falimentimit të Shoqërisë “G&T” sh.p.k., në falimentim, në lidhje me vijimësinë e procedurës dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN

1. Shoqëria “G&T” sh.p.k. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, e cila ushtron aktivitetin tregtar në fushën e “*design*”, aplikime grafike, shtypshkrimin e botimeve të ndryshme, fletëpalosje, postera, ftesa, kartëvizita, reklama televizive dhe xhami ndriçues etj. Konstruksione metalike dhe veshje fasadash, importimin dhe eksportimin e artikujve të përruar dhe gjysmë të përpunuar të metaleve me ngjyrë për prodhim reklamash, prodhim mjeteve lundruese”.

2. Me vendimin nr. 5992, datë 9.6.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit Shoqëria “G&T” sh.p.k.

- Hapjen në orën 15:00, të datës 9.6.2016, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., me seli në Tiranë, me adresë: rruga “Vorë–Fushë Krujë”, km 5, Fushë-Prezë, Tiranë.

- Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “G&T” sh.p.k. të znj. Shpresa Breçani, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 9, datë 14.10.2014, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara El”, shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë.

- ...

3. Gjatë zhvillimit të procedurës janë mbajtur mbledhja për raportim dhe mbledhja për verifikimin e pretendimeve, të cilat kanë përfunduar me miratimin e tabelave përkatëse të pretendimeve të kreditorëve të shoqërisë “G&T” sh.p.k.

4. Nga ana e administratores së falimentimit me shkresën e depozituar me nr. 4042 prot., datë 20.5.2019, është vënë në dispozicion tabela e shpërndarjes përfundimtare për masën e falimentimit, në shumën 690,492 lekë.

5. Me vendimin nr. 313 akti, datë 30.5.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

1) Pranimin e kërkesës.

2) Miratimin e shpërndarjes përfundimtare të masës së falimentimit në shumën 690,492 lekë, sipas tabelës së paraqitur nga administratorja e



falimentimit e shoqërisë “G&T” sh.p.k., në falimentim, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

3) Shpërndarja e masës së falimentimit, sipas tabelës së miratuar, do të bëhet nga administratorja e falimentimit e shoqërisë “G&T” sh.p.k. në falimentim, pas diskutimit të vërejtjeve, sipas neneve 160 dhe 157 të ligjit, në mbledhjen përfundimtare të kreditorëve të falimentimit, në afatet dhe mënyrën që do të caktohet nga Gjykata në këtë mbledhje.

4) Caktimin e mbledhjes përfundimtare të kreditorëve të falimentimit, e cila do të mbahet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 26.6.2019, ora 10:00, kati i tretë. Mbledhja përfundimtare e kreditorëve të falimentimit do të ketë si rend dite:

a) Diskutimin e llogarive të paraqitura nga administratori i falimentimit;

b) Paraqiten e vërejtjeve ndaj listës përfundimtare të shpërndarjes.

c) Diskutim mbi vijimësinë e procedurës.

5) Kreditorët e falimentimit kanë të drejtë të paraqesin me shkrim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në 7 ditë para datës së caktuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, vërejtjet ndaj listës përfundimtare të shpërndarjes, nëse ata kanë. Nëse kreditori i falimentimit është person juridik, kërkesës me shkrim duhet t'i bashkëlidhet një ekstrakt lëshuar nga QKB-ja (në original) dhe një autorizim të posaçëm lëshuar nga administratori për përfaqësuesin. Mospërmbushja e këtyre kriterëve formale bën kërkesën e papranueshme për shqyrtim.

6) Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet personalisht administratorës së falimentimit Shpresa Breçani.

7) Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet nga administratorja e falimentimit, personalisht, kreditorëve të falimentimit dhe debitorit shoqërisë “G&T” sh.p.k., në falimentim.

8) Një kopje e këtij vendimi të shpallet publikisht në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekt njoftimi publik.

6. Në datën 26.6.2019 u mbajt mbledhja përfundimtare e kreditorëve, në të cilën u diskutuan llogaritë e paraqitura nga administratorja e falimentimit dhe u kërku

paraqitja e vërejtjeve lidhur me të dhe listën përfundimtare.

7. Gjatë procedurës së falimentimit, në referim të nenit 17, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar, nga ana e administratorës së përkohshme të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., shoqëri në falimentim, është kërkuar informacion në rrugë zyrtare nga institucionet e kredisë, institucionet e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, në zyrat përmbarimore, si dhe në institucione të tjera në funksion të dhënies së informacionit të nevojshëm për procedurën e falimentimit.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 313 akti, datë 10.5.2019, ka vendosur urdhërimin e menjëhershëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, për të hequr të gjitha urdhrat e sekuestros dhe të bëjë zhblokimin e pasurive të luajtshme të Shoqërisë “G&T” sh.p.k., në falimentim, në favor të masës së falimentimit që administrohet nga administratorja e falimentimit Shpresa Breçani, me qëllim shitjen e tyre.

9. Pas mbledhjes përfundimtare të kreditorëve, me shkresën nr. 5496 prot., datë 2.7.2019, administratorja e falimentimit njoftoi Gjykatën, për kalimin e shumës së grumbulluar në përfundim të procedurës, në favor të kreditorit të vetëm të preferuar Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

10. Bazuar në nenin 163, të ligjit për falimentimin, sipas të cilit: “*Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtar, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht*”.

11. Në nenin 1, të ligjit për falimentimin, përcaktohet se: “*Procedura e falimentimit ka për qëllim të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose, në rastin e një plani riorganizimi nëpërmjet arritjes së një marrëveshje tjetër, me synimin kryesor, ruajtjen e veprimtarisë së tij*”.

12. Nga përmbajtja e këtij neni del qarte se janë njohur dhe pranuar dy mënyra të shlyerjes kolektive të detyrimeve të debitorit: a) nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive dhe shpërndarjes së të ardhurave; b) nëpërmjet plan-riorganizimit /një marrëveshje, që synon ruajtjen e



veprimtarisë së debitorit. Nga përcaktimi i këtij neni, Gjykata çmon në rastin konkret, objekt gjykimi, nuk ndodhemi përpara një plani riorganizimi i cili u nënshtrohet rregullimeve të parashikuara konkretisht në këtë ligj, por shlyerjes në mënyrë kolektive të detyrimeve të debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave.

13. Ligji i posaçëm dhe pse në nenin 1 të tij jep qëllimin e procedurës së falimentimit dhe mënyrat e realizimit të tij, nuk përcakton shprehimisht pasojat që vijnë nga likuidimi për shkak të falimentimit të debitorit/shoqërisë; nuk përmban dispozita të veçanta mbi pasojat për likuidimin për shkak falimentimi lidhur me vetë debitorin shoqëri, gjë e cila passjell dhe zbatimin e dispozitave të ligjit tregtar mbi likuidimin e një shoqërie tregtare, për sa u përket pasojave (ligji për falimentimin parashikon vetëm shpërndarjen e të ardhurave dhe të drejtat e kreditorëve të falimentimit mbas mbarimit të procedurës së falimentimit sipas neneve 164–167).

14. Pavarësisht shkakut të likuidimit (vullnetar apo falimentim) në thelb qëndron e njëjta situatë: likuidim i të gjithë pasurisë së subjektit/shoqërisë dhe shpërndarjen e të ardhurave. Në ligjin për shoqëritë tregtare gjejmë të pasqyruar pasojat që vijnë nga likuidimi në përfundim të tij: prishja e shoqërisë dhe çregjistrimi i shoqërisë, pasi kemi të bëjmë me një subjekt që nuk mund të vazhdojë me aktivitetin e tij, të cilit tashmë i është likuiduar e gjithë pasuria dhe shpërndarë të ardhurat.

15. Pasoja, prishja e shoqërisë dhe çregjistrimi i shoqërisë nga likuidimi për shkak falimentimi është i parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, me ndryshimet. Neni 99 i tij, sipas së cilit përcaktohet, se: “1. shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet: b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit; ... 5. prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, për shkak të

pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit ...”.

16. Nga ana tjetër ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 51, i ndryshuar, ligj i cili, gjithashtu, parashikon dhe rregullon edhe pasojat e çregjistrimit në nenin 53, të tij përcakton çregjistrimi me vendim gjyqësor: “*Subjekti mund të çregjistrohet në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që vendos se subjekti prishet, mbaron apo nuk mund të ushtrojë më veprimtari. QKR-ja çregjiston kryesisht subjektin, në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, me anë të të cilit vendoset çregjistrimi i subjektit në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon procedura likuidimi për këto subjekte ose në vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit apo të procedurave të tjera që mund të kërkojnë sipas ligjit.*”.

17. Nga sa më lart parashtruar, Gjykata arrin në përfundimin se me kryerjen e shpërndarjes së fundit kreditorëve të falimentit, mbyllet procedura e falimentimit dhe shoqëria tashmë është një shoqërie e likuiduar për shkak falimenti/e falimentuar dhe si e tillë konsiderohet e prishur dhe duhet të çregjistrohet nga regjistri tregtar pranë QKB-së, si dhe në pasojë nga të gjitha organet e tjera, si: tatimore, doganore etj., në të cilat është e regjistruar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306–308 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijuese, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., me NIPT K31902010N, me administrator Perparim Kurti, me seli në Tiranë, adresa: rruga. “Vorë-Fushë-Krujë”, km 5, Fushë-Prezë, Tiranë.

2. Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “G&T” sh.p.k. nga regjistri tregtar i shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit shoqërisë “G&T” sh.p.k., në Buletin Zyrtar të Njoftimeve Publike.



4. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

5. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

7. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

8. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet personalisht administratores së falimentimit Shpresa Breçani.

9. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet nga administratorja e falimentimit personalisht kreditorëve të falimentimit dhe debitorit shoqërisë “G&T” sh.p.k., në falimentim.

10. Administratori i falimentimit dhe kreditori i falimentimit kanë të drejtë të paraqesin kërkesë para kësaj Gjykate, për shpërndarje, të vonuar, në kushtet e nenit 166 dhe vijues të ligjit.

11. Shpenzimet e procedurës së falimentimit janë në ngarkim të masës së falimentimit.

12. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit shoqërisë “G&T” sh.p.k., bashkë me tabelën e shpërndarjes përfundimtare të administratores së falimentimit Shpresa Breçani, t’i komunikohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për verifikimin e konsumimit të veprave penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit.

13. Kundër vendimit, palët në procedurën e falimentimit kanë të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar ose nga dita e nesërme e shpalljes publike të vendimit të arsyetuar në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës dhe në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

U shpall në Tiranë, sot, në datën 6.9.2019.

SEKRETARE
Rovena Behaj

GJYQTARE
Marinela Osmani

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019